



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni vjeshtor*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.01/2017

Prishtinë, më 10 tetor 2017

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Frashër Krasniqi, Saranda Bogujevci, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Mungoi: Mytahir Haskuka.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Basri Berisha-IAP dhe Florije Kryeziu-UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

**1. Konstituimi i Komisionit**

**Duda Balje**, në fillim të mbledhjes përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe iu uroi punë të mbarë të gjithë anëtarëve të komisionit të legjislaturës VI. Ajo tha se fushëveprimi i këtij komisioni është mjaft i rëndësishëm, ku ajo kishte qenë anëtare e këtij komisioni edhe më parë. Balje më pas theksoi se në legjislaturën e kaluar kryetare e këtij komisioni ishte znj. Lirije Kajtazi, e cila tani është nënkryetare e parë dhe do të na paraqet një rezymë të shkurtër të punës dhe aktiviteteve të Komisionit, ato që janë përfunduar dhe ato që mund të jenë prioritet për aktivitetet e ardhshme.

Balje njoftoi se nga qeveria është proceduar Projektligji për plotësim ndryshimin e Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë, ndërsa më vonë pritet të procedohet në Kuvend edhe Projektligji për Mbrojtjen e Fëmijës.

Në vazhdim u prezantuan të gjithë anëtarët e Komisionit Funkcional, të cilët u zotuan për angazhim dhe bashkëpunim maksimal, në mënyrë që plani i punës së komisionit të plotësohet dhe të avancohet sa më shumë që është e mundur.

**Lirije Kajtazi**, tha se në mandatin e kaluar ka udhëhequr këtë Komision, ku është bërë punë mjaft e madhe, por si brengë ka mbetur Projektligji për Mbrojtjen e Fëmijës, në të cilin gjatë mandatit të kaluar kemi bërë një punë mjaft të mirë, por për shkak të shpërbërjes së Kuvendit nuk ka arritur të procedohet për shqyrtim të dytë në Kuvend. Po ashtu, si punë e pakryer ka mbetur edhe zgjedhja e zëvendësve të Avokatit të Popullit. Ajo përmendi edhe Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Lirinë Fetare, i cili më parë nuk ishte miratuar në parim në Kuvend.

**Teuta Haxhiu**, theksoi se në mandatin e kaluar është punuar shkëlqyeshëm në Projektligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, mirëpo nuk ka arritur të shqyrtohet në Kuvend. Qeveria me siguri do ta procedojë këtë Projektligj në Kuvend dhe ne si Komision do ta kemi më të lehtë shqyrtimin e këtij Projektligji, pasi që si Komision e kemi pasur të përfunduar shqyrtimin dhe amendamentimin e tij. Projektligjin për plotësim ndryshimin e Ligjit për Lirinë Fetare do ta kemi së shpejti në agjendën e Komisionit dhe duhet te punojmë në këtë Projektligj, ashtu siç do të shqyrtojmë edhe zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit, çështje kjo e cvla ka mbetur pezull, nga legjislatura e kaluar.

Ajo propozoi që në parim mbledhjet e Komisionit të mos të caktohen ditën e martë, pasi që këtë ditë e ka caktuar Komisioni për Arsim, ku ajo dhe deputetja Albulena Balaj, janë anëtare.

**Mexhide Mjaku Topalli**, tha se Projektligji për Mbrojtje e Fëmijës është i përfunduar, dhe vetëm duhet të ndiqen procedurat në Kuvend për miratim.

Ajo propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohet ministri i MPMS-së, ku ai do të referojë lidhur me zbatimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë si dhe për zbatimin e Ligjit për skemat pensionale. Një kërkesë të tillë e kishte bërë edhe në legjislaturën e kaluar, por për shkak të shpërbërjes së Kuvendit, kjo nuk u bë.

**Duda Balje, kryetare**, propozoi që Komisioni Funkcional në mbledhjen e radhës të ftojë ministrin e MPMS-së, për të diskutuar lidhur me çështjet e ngritura nga deputetja Mexhide Mjaku- Topalli.

Anëtarët e komisionit, u pajtuan në parim që mbledhjet e komisionit të mbahen ditën e mërkurë, në orën 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

*E përgatiti:*

*Stafi Mbështetës i Komisionit*

Kryetarja e Komisionit,

---

Duda Balje